

# AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQERISE

TIRANA ENGINEERING & CONSTRUCTION

SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

### Neni 1:

#### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sipas kerkesave te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" sot, me **16.11.2023** eshte krijuar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar TIRANA ENGINEERING & CONSTRUCTION SH.P.K., shkurtimisht do te njihet me emertimin T.E.C. shpk, shoqeri e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe nenet e ketij statute.

**Emri i shoqerise** do te jete "TIRANA ENGINEERING & CONSTRUCTION" SH.P.K.

**Shkurtimi i emërtimit te shoqerise:** do te jete T.E.C shpk

**Themeluesit i shoqerise** eshte: **Z. Florenc Ajazi**, atësia Xheviti, amësia Engjellushe, shtetas Shqiptar, lindur në Çorovodë, Skrapar dhe banues në TIRANË, me adresë rruga Pandeli Cale, Nd. 20; H. 3; Ap. 20; Njësia Administrative nr.5, 1019; Tiranë, lindur më 05.04.1975, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035827775 dhe nr. personal H50405034K.

### Neni 2:

#### Objekti i veprimtarise

Në fushën e ndërtimit, si punime dheu, murature, betoni, carpenterie, betonarme të zakonshme, punime shembjesh, ndërtime civile shumë katëshe, rezidenciale, individuale, industriale, turistike, bujqësore dhe instalimet e nevojshme për to, punime rikonstruksioni dhe restaurimi, ujësjellësa, kanalizime, impiante vaditëse, mirëmbajtje shërbime në sistemin komunal.

Në fushën e projektimit të objekteve civileshumë katëshe, rezidenciale, individuale, industriale, turistike, bujqësore, etj.

Konsulenca në fushën e ndërtimit të gjitha llojeve, si dhe në fusha të tjera për të cilat shoqëria ka ekspertizën e duhur profesionale.

Në fushën e tregtimit të mallrave të ndryshme industriale me shumicë dhe pakicë. Import - eksport, pajisje e makineri, artikuj industria.

Studim, projektim, ndërtim dhe investime ne fushen e energjitetes elektrike.

Shoqeria ka te drejte te ushtroje cdo lloj aktiviteti te parashikuar nga ligji ne perputhje me rregullat e disopozitat ne fuqi.

### Neni 3:

#### Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete pa afat.



#### **Neni 4:**

**Selia**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Pandeli Cale, Nd. 20; H. 3; Ap. 20; Njësia Administrative nr.5, 1019; Tiranë.

#### **Kreu II**

**Neni 5**

#### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestari i shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) Lekë. Pjesmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtme:

Ortaku themelues Florenc Ajazi: Zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10.000 (dhjetë mijë) Lekë që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut është në para.

#### **Neni 6:**

#### **Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogelimi prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7**

#### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE**


#### **Neni 8**

#### **Organë Vendimarrës**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

2  


- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore për dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatyё dhe në procedimet e tjera ndaj administratorve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

Ortak mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 9**

#### **Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këti neni, ajo mund të marrë, vendime, pavarësisht parregullsisë vetem me pjesmarrjen e ortakeve qe zoterojne 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### **Neni 10**

#### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkijnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkijnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Për Tregtarë dhe Shoqëritë Tregtar", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave (me shume se 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë), janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkressë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet përshkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

### **Neni 11**

#### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.



Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi I politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorove;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduiduesve dh etë ekspertëve kontabël të autorizuar;
- c) përcaktimin e shpërblimeve;
- d) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim I statutit duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

### Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votes

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- A) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- c) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlersohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku të cilin përfaqëson.

### Neni 13 Administrimi

(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorit prodhon efekte nga emerimi nepermjet ketij statuti per administratorin e pare dhe regjistrimit te tij në Qëndrën Kombëtare të Biznesit per administratoret e ardhshem.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këti ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bëre në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

**(3) Si administrator i parë i shoqërisë per një afat 5 vjecar duke filluar nga data 16.11.2023 deri me date 15.11.2028 caktohet:**

**Z. Florenc Ajazi**, atësia Xheviti, amësia Engjellushe, shtetas Shqiptar, lindur në Çorovodë, Skrapar dhe banues në TIRANË, me adresë rruga Pandeli Cale, Nd. 20; H. 3; Ap. 20; Njësia Administrative nr.5, 1019; Tirana, lindur më 05.04.1975, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035827775 dhe nr. personal H50405034K.

### Neni 14 Kompetencat e Administratorove

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- c) përgatisin dhe nënshkrujnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurise së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet per shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;



- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qëndrën Kombëtare të Biznesi;
- e) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marëdhënievebkontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 15

### Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkeljë të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojet e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojet përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për tregtarë dhe Shoqëritë Tregtare”, administrator detyrohet:

1.a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vemendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlersojë me përgjegjsi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konflktit, present apo tëmundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrate të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë tragtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlersimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, është i detyruar t'i dëmshpërbujejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrate të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.



4. Në mënyrë të veçantë por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit, Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV Viti finansiar-ekspertet**

##### **Neni 16 Viti Financiar**

Viti finansiar i shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimi, viti i pare finansiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Bisnesit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 17 Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimitarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithvejetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergaatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### **Kreu V Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

##### **Neni 18 Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njostuar pezullimi i veprimitarise në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- d) me vendim të gjykatës;



Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoperi ne likuidim e siper".

Prishja e shoqërise tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 19**

#### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

#### **Neni 20**

#### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### **Neni 21**

#### **Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

### **ORTAKU**

**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**TIRANA ENGINEERING & CONSTRUCTION SHPK**

**FLORENC AJAZI**

